



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

Nr. 3856 Prot.

Vau Dejës, me 20.06.2024

Lënda: Njoftim për mbledhjen e Këshillit Bashkiak Vau Dejës

Drejtuar: Anëtarëve të Këshillit Bashkiak Vau Dejës

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore” neni 53 pika 4, neni 56 pika 2, neni 57 pika 2 germa c, ju njoftojmë se mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës zhvillohet ditën e Mërkure me datë 26.06.2024, ora 15:00. Mbledhja do të zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Vau Dejës, Njësia Administrative Bushat.

Me këtë rend dite:

1. Projekt vendim për miratimin e mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak Vau Dejës Znj.Majlinda Zef Ndreca.
- 2.Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Maj 2024.
- 3.Projekt vendim për shprehjen e mendimit në lidhje me ndryshimin e nivelit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura të shoqërisë rajonale ujësjellës kanalizime Shkoder Sh.A.
- 4.Projekt vendim për miratimin e planit të përmirësimit të shërbimit për arsimin parashkollor në Bashkinë Vau Dejës.
- 5.Projekt vendim për shtesën e buxhetit të Bashkisë Vau Dejës, vkb nr.91 datë 21.12.2023, sipas akt marrëveshjes nr.64/1 datë 09.04.2024, ndermjet Këshillit Qarkut Shkoder dhe Bashkisë Vau Dejës.
- 6.Raport i monitorimit të Bashkisë Vau Dejës për periudhën Janar-Prill 2024 dhe vetëvlerësimin e gjendjes financiare Janar-Prill 2024.
- 7.Projekt vendim për miratimin e projektit të parë të PBA 2025-2027 për Bashkinë Vau Dejës.
- 8.Projekt vendim për dhënie pelqimi në parim për dhënie në përdorim me anë të konkurrimit publik, me afat deri në 10 vjet, të sipërfaqes prej 0.2973 ha, pjese e pasurisë nr.22, Zk 1100, e llojit “kullotë” në fshatin Barbullush, pronë e Bashkisë Vau Dejës “Për mbarështimin e faunes së egër dhe gjahut”



9. Projekt vendim për miratimin e vleres maksimale të subvencionit të qirasë në tregun e lirë për vitin 2024, për familjet që përfitojnë subvencionin e qirasë në tregun e lirë, sipas strukturave përkatëse të banesave.

10. Projekt vendim për ndryshimin e VKB nr.31 datë 29.04.2024 “Mbi dhënie e ndihmës financiare të menjëhershme familjeve të dëmtuara nga tërmeti i dt.26.11.2019”

11. Projekt vendim për ndryshimin e VKB nr.71 datë 28.09.2023 “Mbi miratimin e objektit Urë Pasarelë me hapësirë drite HD 80ml në fshatin Mnelë e vogël”.

12. Të ndryshme.

Komisionet e këshillit do mblidhen ditën e Marte, datë 25.06.2024 ora 09.00 pranë Nj.A Bushat.

-Komisioni Mandateve.

-Komisioni i bujqësisë, pyjeve, menaxhimit të ujërave, mbrojtjes së mjedisit dhe biodiversitetit.

-Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut.

-Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake dhe planifikimit të zhvillimit strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare.

-Komisioni i Siguri së Publike, Emergjencave Civile dhe Rehabilitimit.

-Komisioni i kultures, trashëgimisë kulturore, dhënies së titujve, emërtimeve.

Kryetari Këshillit

Ervys Shimaj

